Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr.Br. 265/19, 277/19
Datë/Datum. 01.07.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 265 / 19
277/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje:z. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi– Referues dhe z. Goran Milenković - Anëtar,duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k"për Lot 1 dhe 2 dhe OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk,për Lot 2, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë për pjesa e I OE "Famis CO –HC " ndërsa për pjesën II OE: Damastion Projekt Shpk & Via Egnatia Shpk&Urban, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja rutinore dhe dimërore te autoudhës A7 Ibrahim Rugova dhe A6 nga udhëkryqi A7 A6 deri në kyçjen në Konjuh si dhe rrugën Nacionale N9" me numër të prokurimit: 205-19-1262-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/"Ministria e Infrastrukturës"/MI/, më datën 25.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.**APROVOHEN**, pjesërisht si te bazuara ankesat e operatorëve ekonomik:"Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" dhe OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Mirëmbajtja rutinore dhe dimërore te autoudhës A7 Ibrahim Rugova dhe A6 nga udhëkryqi A7 A6 deri në kyçjen në Konjuh si dhe rrugën Nacionale N9" me numër të prokurimit: 205-19-1262-2-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- "Ministria e Infrastrukturës" pjesa I dhe II.

II.**VERTETOHET**, njoftimit për dhënie te kontratës pjesa I dhe II (për pjesët –Lotet qe ankuesit kanë parashtruar ankese) lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Mirëmbajtja rutinore dhe dimërore te autoudhës A7 Ibrahim Rugova dhe A6 nga udhëkryqi A7 A6 deri në kyçjen në Konjuh si dhe rrugën Nacionale N9" me numër të prokurimit: 205-19-1262-2-1-1 AK-"Ministria e Infrastrukturës".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" dhe OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk aprovohen pjesërisht si e bazuar, i'u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:18.03.2019
Data e hapja së ofertave është bërë me dt:13.05.2019
Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit te pasuksesshëm është bërë me dt: 14.05.2019
Data e Vendimit të AK për dhënie është bërë me dt : 14.05.2019.

Kundër njoftimit te autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik"Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" dhe OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk me dt:17 dhe 20.05.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues- "Ministria e Infrastrukturës" me datën 20 dhe 22.05.2019,ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: "Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" dhe OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me30.05.2019 me nr. 264/19,ndërsa OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk ka deponuar ankesë në OSHP, me 01.06.2019 me nr. 277 / 19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë për Lot 2 OE: Damastion Projekt Shpk & Via Egnatia Shpk&Urban,

lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja rutinore dhe dimërore te autoudhës A7 Ibrahim Rugova dhe A6 nga udhëkryqi A7 A6 deri në kyçjen në Konjuh si dhe rrugën Nacionale N9" me numër të prokurimit: 205-19-1262-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ "Ministria e Infrastrukturës" /MI/,duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,59,si dhe neni 60të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt:18.06.2019,lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues "Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" dhe OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk në finalizim te analizimit dhe shqyrtimitte këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:
PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "TË PARASHTRUARA NGA "MILENIUM KONSTRUCTION"SH.P.K DHE INTEGRAL SH.P.K. ANKESËN ANKESA NR. NR. 265/19.
OE ankues"Milenium Konstruction"Sh.p.k dhe Integral Sh.p.k." sh.p.k."Prishtinë, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së,sipas OE ankues .
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është te sigurojnë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë te shfrytëzimit te fondeve publike ,duke përcaktuare kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do të respektohen dhe detyrimit qe do te përmbushen, andaj edhe trajtimi si OE i eliminuare Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 1 të LPP-së . Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues "Milenium Konstruction"Sh.p.k dhe Integral Sh.p.k." sh.p.k."Prishtinë, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së,sipas OE ankues .
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrë më ekonomike,duke e marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit,andaj trajtimi i OE. ankues i eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së .
Ekspertja profesionale e prokurimit konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues"Milenium Konstruction"Sh.p.k dhe Integral Sh.p.k." sh.p.k."Prishtinë, pretendojnë se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së,sipas OE ankues .
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe trajtimi si OE i eliminuar, Operatorin ekonomik ankues nuk është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së .Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues "Milenium Konstruction"Sh.p.k dhe Integral Sh.p.k." sh.p.k."Prishtinë, pretendojnë se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së,sipas OE ankues
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit, i cili (pas kërkesës për sqarime) Operatorin Ekonomik ankues e ka trajtuar si OE. të eliminuare dhe trajtimi si OE. i eliminuare është në harmoni me nenin 59 të LPP-së .
Sepse kriter në NJ.K. dhe në D.T .te specifikat teknike janë kërkuar për pjesën-Lot 1 dhjet (10) Borëheqëset (Pollugjet) dhe dhjetë shpërndarit automatik të kripës ,gjithashtu edhe për
Lot 2 janë kërkuar dhjet (10) Borëheqëset (Pollugjet) dhe dhjet shpërndarësit automatik të kripës.

Kurse OE ankues nuk ka arritur të sjell dëshmi siç janë kërkuar për ta plotësuar këtë kriter,sepse nuk ka ofruar dëshmi se posedon apo ka marr me qira dhjetë(10) shpërndarës të kripës dhe dhjetë (10) Borëheqës (plugjet).

Sa i përket pretendimit të OE ankues i cili thekson se përderisa shkruan në librezë të qarkullimit :Pajisje për pastrim të borës ,automatikisht nënkupton se është e kompletuar me pajisje përcjellëse që përfshinë Borhedhesit ,pllugjet dhe shpërndarësit automatik të kripës ,ndërsanëse nuk do ishte e kompletuar pajisja do të shkruan Pjesë për pastrimin e borës.
Sa i përket këtij pretendimi sqaroj se (nga 10 Librezat e automjeteve të ofruara) nuk shkruan në të gjitha Librezat Pajisje për pastrimin e Borës,dhe ky pretendim i vet OE. ankues bie në kundërshtim me dokumentet e ofruara.

Vlen të ceket se OE ankues ka ofertuar në të dy Lotet dhe shih kriterin dhe dëshmi që janë të obliguara për ofertuesit që konkurrojnë në të dy Lotet:
Kërkesa 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 për pjesën I dhe pjesën 2.

Dëshmia 5. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).

Vëmendje: Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Nëse OE aplikon për dy pjesë (lot) atëherë duhet te ofrohen pajisje për dy pjesët (Lotet) sipas listës tek Aneksi 1.

Kurse OE nuk ka arritur ti siguroj dëshmi konform NJ.K. dhe në D.T.

OE ankues pretendon se i plotëson kushtet për të dy Lotet dhe është me çmim ma të lirë kurse sa i përket fituesit për Lot 1 nuk ka ndonjë pretendim se nuk i plotëson kushte andaj edhe nuk është analizuar oferta e fituesit për Lotin 1 sepse edhe ashtu nuk ka pasur ndonjë pretendim nga OE.ankues përveçse ka pretenduar se oferta e tij

i plotëson kriteret për të dy Lotet.

Ekspertja konstaton se këto pretendime janë të pa bazuara .

OE ankues "Milenium Konstruction" Sh.p.k dhe Integral Sh.p.k." sh.p.k."Prishtinë, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 60 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të respektohen kriteret për dhëniene kontratës dhe kriter për dhënien e kontratës ka qenë :

Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Sa i përket pretendimit se OE ankues i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. nuk qëndron dhe është i pa bazuar,

Kurse sa i përket fituesit nuk është respektuar qëllimi i këtij neni .

Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht ibazuare .

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: "të parashtruara nga OE "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë, ANKESA nr.Nr.277/19

OE ankues "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së,sipas OE ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është te sigurojnëmënyre ma efikase ,me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimit qe do te përmbushen, andaj edhe trajtimi si OE. i eliminuar Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 1 të LPP-së

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues'' EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë,, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrë me ekonomike ,duke e marr ne konsideratëqëllimin dhe lenden e prokurimit,andaj trajtimi i OE. ankues të eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së .

Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues""EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë,, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuare nenin 7 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe trajtimi si O.E. i eliminuar, Operatorin ekonomik ankues nuk është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së .Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues""EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë,, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 56- të LPP-së – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave –dhe neni 26 i RROUP (kriteret e përzgjedhjes , dhe i njëjti pretendon se OE. i shpallur fitues nuk i ka plotësuar kërkesat e kualifikimit (përzgjedhjes) te specifikuara në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, i njejti ka aplikuar për te dy llotet ,dhe nuk i ka plotësuar kërkesat e kapacitetit teknik të nenit 9.1& 9.2 pika 5 te FDT-së së D.T.(nuk i ka ofruar pajisjet për të dy pjesët sipas listës te aneksi 1)sipas OE.ankues ,

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të respektohen kriteret e parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe vlerësimi të bëhet konform këtij neni, sikurse e ka potencuar edhe

OE. ankues ky ndërlidhet edhe me disa nene tjera dhe ato janë : paragrafi 2 i nenit 51 te këtij ligji ,specifikave teknike që kërkohen në bazë të neni 28 të këtij ligji ,gjithashtu ndërlidhet edhe me nenin 60 të këtij ligji, ne bazë te cilat është paraparë kriter –Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Shih neni 56 i LPP-së si e rregullon këtë çështje ,

1. Tëgjithakontratatpublikedotëjepensipasproceduravetëthemeluarapërnjëseleksionim tëtillë,dhe përmes:

1.1.Së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit2. Të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Shih kriteret e parapara te nenit 9.1& 9.2 te FDT-së te Dosjes se Tenderit e te cilat ndërlidhen me pretendimin nr. 4. Ku OE ankues pretendon se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson këto kushte:

Kërkesa 4Lista e kontratave te realizuara përfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 3,500,000.00 euro për pjesën I dhe 3,000,000.00 euro për pjesën II . Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve

Kërkesa 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 për pjesën I dhe pjesën 2.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 4. Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare

Vëmendje: Shembull nëse shuma totale e kontratave për punë e kërkuar për Lot 1 është 3,500,000.00 dhe për Lot 2 është 3,000,000.00 atëherë kërkesa minimale e kontratave te realizuara e cila duhet te përmbushet nga OE i cili aplikon për dy pjesë te (lot) është6,500,000.00 euro.(shkruante si dëshmi 7,500,000.00 por AK-së e ka korrigjua me Letër standarde dhe obligative për ofertuesit është 6,500,000.00 euro.)

Dëshmia 5. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).

Vëmendje: Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Nëse OE aplikon per dy pjese (lot) atëherë duhet te ofrohen pajisje per dy pjesët sipas listës tek Aneksi 1.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1.OE duhet te ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve te fundit ka qene ne vlere prej jo me pak se pjesën I 4, 000,000 eruo dhe pjesën II 3,000,000.00 euro

Kërkesa 2.Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 € për pjesën I dhe prej së paku 250,000.00 € për pjesën II ose qasje në kredi nga një bankë duke emërtuar projektin për te cilin lejohet kredia.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia – 1 Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit

Dëshmia - 2 Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi , dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucion

Vëmendje! Shembull nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 4,000.000.00 euro dhe për Lot 2 2 është 3,000,000.00 atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet te përmbushet nga OE i cili aplikon për dy pjesët (lot) është 7,000,000.00 euro Nëse OE aplikon për te dy pjesët atëherë mbështetja financiare duhet te jete 550,000.00 euro

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar sepseOE.i rekomanduar për kontratë ,ne listën e projekteve të realizuara ne tri vitet e fundit i ka dhënë si vlerë totale 5,655,731.12 Euro (pesë milon e gjashtëqind e pesëdhjeta e pesëmijë e shtatëqind e tridhjetë e një euro e dymbëdhjeta cent) kurse kriter ishte 6,500,000,00euro (gjashtë milon e pesëqindind euro),gjithashtu edhe referencat nuk janë konform kritereve te parapara me DT. dhe NJ.K. (I njëjti ka ofertuar për te dy Lotet)

Gjithashtu qëndron pretendimi i OE . ankues se OE. i rekomanduar për kontratë nuk i posedon Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik te parapara me NJ.K dhe D.T. nuk janë konform dosje te tenderit tek Aneksi 1 për

pjesën I dhe pjesën 2. Sepse OE . I rekomanduar për kontratë ka ofertuar në të dy llotet dhe me një par pajisje kurse kriter ishte ,Nëse OE aplikon per dy pjese (lot) atëherë duhet te ofrohen pajisje për dy pjesët (lotët)sipas listës tek Aneksi 1.

Gjithashtu edhe ato pajisje që janë ofruar nuk janë konform DT. dhe NJ.K. psh te Pajisjeve dhe Mekanizmi i nevojshëm ne nr. 15 është kërkuar Traktor 60KF me rimorkio ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar Traktor Maseey Ferguson tipi 355-4 numri identifikues 5310P29092 viti i prodhimit 1990 ngjyra e kuqe e hirit targat 01-495-VA

mirëpo te njëjtit i mungon 60KF në librezën e ofruare .

Gjithashtu te kapaciteti ekonomik dhe financiar i ofruar nga OE. i rekomanduar për kontratë nuk i plotësonkriteret e parapara sepse për OE. që oferton në të dy llotet do duhej të sjell dëshmi të qarkullimit bankar për tri vitet e fundit ne vlerë prej 7,000,000.00 (shtat milion eurove),kurse OE i rekomanduar për kontratë ka sjell dëshmi të qarkullimit vetëm për 4.480.857.23 (katër milion e katërqind e tedhjet mije e tetqind e pesdhjet e shtatëeuro e njezetetrecent)

Andaj Ekspertja Konstaton se pretendimi është i bazuar .

OE ankues"EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit i cili OE. ankues e ka trajtuar si OE. të pa përgjegjshëm dhe trajtimi si OE i eliminuar Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 59të LPP-së .

Sa i përket pretendimit se OE. ankues lidhur me shkeljen e paragrafin 2 dhe 4 të këtij neni i njëjti pretendim nuk qëndron sepse autoriteti kontraktues nuk ka pasur diçka të paqartë rreth regjistrimit të automjetit sepse te njëjtat gjinden në Librezën e Automjetit dhe ka qen e çart për AK- së Automjeti është pa regjistrim kurse në NJ.K. dhe në D.T. ka qen kriter që automjetet duhet të jenë të regjistruara ,ketë e pranon edhe vet OE .ankues me rastin e përpilimit të kësaj ankese .

Sa i përket pretendimit të OE .ankues,se mosregjistrimi i Automjetit hyjnë ne devijime te vogla dhe nuk është rrethanë relevante ,Ekspertja mendon se çdo kriter është relevant dhe i obligueshëm për ofertuesit dhe AK-së

Kurse devijimet e vogla janë sqaruar në parg. 4 te nenit 59 te këtij ligji, Shih pargafin 4 :

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tenderi të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimi të tenderëve.

Ky pretendim ndërlidhet me nenin 39 të RRUOP-it ku ekskluzivisht nuk e sqaron për regjistrimin e automjetit por e njëjta hyn te specifikat teknike në aneksin 1 te D.T. andaj mos përmbushja e Specifikave teknike edhe në RRUOP.,
te sqarimet parashihet të refuzohet tenderi .
Sa i përket pretendimit se AK-së e ka eliminuar padrejtësisht OE ankues nuk qëndron,
Kurse sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret e parapara me NJ. K. dhe D.T. pretendimi i OE. ankues është i bazuar .
Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar .

OE ankues"EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë,, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së,sipas OE ankues .
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të respektohen kriteret për dhënien e kontratës dhe kriter për dhënien e kontratës ka qenë :

Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Sa i përket pretendimit se OE ankues i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. nuk qëndron dhe është i pa bazuar, ndërsa
Lidhur me pretendimin se OE. i rekomanduare për kontratë nuk i plotëson kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. pretendimi është i bazuar.

Ekspertja konstaton ky pretendim është pjesërisht i bazuar .

OE ankues""EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 64 të LPP-së, sipas OE ankues .
Lidhur me pretendimin se kërkesa –kriteri që ishte që Regjistrimi i mjeteve nuk është kategori që aplikohet në bazë te LPP-në dhe pretendimi se ky kriter është i pa bazuar në ligj.

Ekspertja sqaron, në ketë fazë nuk mund të kontestohen kriteret siç është paraparë kriteri për Regjistrimin e automjeteve dhe është nënë kompetencat e AK-së të caktojë kriteret e në raste kur OE nuk pajtohen me kriteret e përcaktuar janë afatet për sqarime kur OE. mund të kërkon ti ndryshojnë apo ti heqin ato kritere e assesi në këtë fazë.

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuare .

OE ankues"EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë,, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 69 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Ekspertja sqaron se përmes këtij neni AK-së mund të kërkoj disa sqarime nga OE.te siguroj dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale te kërkuara me DT. Dhe NJ.K. Aftësia teknike dhe profesionale e Ofertuesve andaj lidhur me pretendimin se nuk është zbatuar par 4.5 i këtij neni që nënkupton raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve dhe pretendimi i OE ankues se të njëjtat i posedon dhe padrejtësisht është eliminuar nga gara sipas OE. ankues,

Ekspertja mendon se pretendimi i OE ankues nuk qëndron sepse OE ankues nuk i posedon mjetet siç janë kërkuar me NJ. K. dhe D.T.(siç është sqaruar në përgjigjeje nr.5)

OE ankues "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë,, pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 72 të LPP-së,sipas OE ankues .

Ekspertja sqaron se në bazë të këtij neni mund të kërkohen sqarime ,

Shih nenin 72 te LPP-së

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Ekspertja thekson se ky pretendim është i përsëritur dhe i njëjti është sqaruar në Përgjigjeje nr.5

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese e prokurimit i propozon panelit shqyrtues që ankesat e lartpërmendura të operatorëve ekonomik ankues, të aprovohen pjesërisht - si të bazuara (për arsyen që u cekën te përgjigjeje në secilin pretendim te dy ankesave),dhe i rekomandon panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim .

Operatori Ekonomik ankues "Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" përmes parashtresës me shkrim të datës:20.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues senukpajtohetme raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-ankues "Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k" ankues z. Fetoshi deklaroj: Ne qëndrojmë ne tërësi pran pretendimeve tona ankimore te parashtruara me date 30.05.2019. Ne jemi eliminuar me arsyetimin se nuk kemi ofruar 10 Borëheqësit dhe 10 Shpërndarësit automatik te kripës. Kjo arsye e eliminimit nuk qëndron për shkak qe ne i kemi te gjitha dëshmi dhe dokumentet qe argumentojnë te kundërtën. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime nga ne lidhje me ketë çështje dhe ne me rastin e sqarimeve kemi angazhuar noterin i cili ka dal ne vendin e ngjarjes dhe ka përgatitur procesverbalin për verifikimin e makinerisë aktin N minutes ku ka konstatuar se ne i kemi te gjitha pajisjet dhe makinerinë ashtu siç është kërkuar ne DT dhe tek njoftimi për kontrate dhe ketë akt noterial e kemi dërguar tek Autoriteti Kontraktues por qe Autoriteti Kontraktues nuk e ka marr për baze pa ndonjë arsyetim. Ne pas marrjes se vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim kemi

kërkuar nga Dogana dhe njëkohësisht kemi siguruar edhe te gjithë dokumentacionin ne lidhje me këta 10 kamion special për pastrim te bores dhe te gjithë këta Duda Doganor përputhën me librezat përkatëse te Kamionëve. Këto dëshmi i'a kemi bashkangjitur edhe ankesës por qe nga ekspertja shqyrtuese nuk kemi marr ndenje përgjigje konkrete ne lidhje me këto dëshmi . Deri te kjo mosmarrëveshje sqarim i Autoriteti Kontraktues ka erdh për shkak se ne këto pajisje me rastin e importimit i kemi pasur ne një DUD doganor mirëpo qe tani me janë te sqaruara me dëshmi e ofruara nga ne e qe janë dëshmi te vërtetuara nga Dogana e Kosovës. Autoriteti Kontraktues konsiderojmë se nuk ka shprehur vullnet te mirëfilltë për te ber verifikimin e këtyre pajisjeve sepse edhe ne DT ka qen si përshkrim qe Autoriteti Kontraktues mund te bej verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike profesionale te gjithë OE-ve Tenderues. Pra Autoriteti Kontraktues nuk ka shprehur vullnet për te ber një verifikim te tille edhe pse ka qene shume i lehtë dhe i mundshëm. Ne si dëshmi i dorëzojmë panelit te gjitha këto 10 duda doganor te vërtetuara me vule te doganës dhe te cilat përputhën me librezat e makinerive përkatëse. Ne gjithashtu ne DT kemi bashkangjitur edhe marrëveshjen për huazim te makinerive te noterizuara ashtu siç është kërkuar ne FDT dhe këto marrëveshje i kem me Kompaninë "Dino" SHPK dhe me "NITI N" SHPK.
Ne e kontestojmë ne tërësi mendimin e Ekspertes Shqyrtuese sepse ne ekspertize nuk kemi marrur asnjë përgjigje konkrete ne lidhje me pretendimin tone dhe me dëshmitë e ofruara nga ne me ankese duke u bazuar ne te gjitha këto fakte dhe dëshmi qe i cekem edhe tani po ashtu edhe ne ankese kërkojmë nga paneli shqyrtues qe te aprovohet ankesa jon si e bazuar për 2 Lotet dhe ky AP te kthehet ne rivlerësim si dëshmi i dorëzojmë marrëveshjet për huazimin e makinerisë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesit i OE-së së dytë ankues -"El Bau shpk& Conex Group"shpk z. Pireva deklaroj: Ju njoftojmë se qëndrojmë prapa te gjitha pretendimeve ankimore po ashtu ju njoftojmë se nuk pajtohem me mendimin e Ekspertes për veç pretendimit nr 4 qe pajtona. Ne si OE kemi ofruar te gjitha dëshmitë sipas DT dhe njoftimit për kontrate dhe po ashtu kemi qen me çmim me te ulet se OE i rekomanduar,ndërsa me dt;14.05.2019 kemi pranuar letrën standarde për OE te eliminuar me arsye nr 1 se nuk i kemi dëshmuar 6 shpërndarëse automatike te kripës por kjo arsye nuk qëndron sepse ne kemi ofruar librezat e kamionëve special për pastrimin e bores ku ceket ne libreze se është Kamion për pastrim te bores, ndërsa për kamionët te cilët nuk është cekur ne libreze kemi bashkangjitur dëshmi DUDet doganore për hedhëse kripe dhe plugje bore. Arsyeja e 2-te e eliminimit është se kemi ofruar një kamion me validitet te skaduar te regjistrimit e cila nuk qëndron për arsye se njoftimi për kontrate është bere me 21.03.2019 ndërsa data e dorëzimit ka qen me 19.04.2019 qe i bie se ne momentin e publikimit kamioni ka pas regjistrim deri me dt 19.04.2019 po ashtu ka edhe kontrolle periodike te kontrolle teknike valide deri me date 06.06.2019 qe i bie qe i plotëson te gjitha kriteret për te dal ne trafik. Pajtohem me pretendimin e E.sh. nr4 se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm për shkak se te njëjtat mjete i ka

ofruar për 2 lotet te cilat ka ofertuar dhe po ashtu ka ofruar edhe mjete te OE "Ekskavatori" e cila ka marr pjese ne te 2 lotot.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësueses së AK-së znj. Bllaca deklaroj: Kompania Ne DT dhe njoftimin për kontrate tek kapacitetet teknike dhe profesionale është kërkuar lista e mjeteve dhe e stabilimentet te kompanisë te dëshmohen me: libreze regjistrimi ndërsa pajisjet tjera me faturë, DUD doganor etj. Kompania Mileniumi për Lot 1-shin i mungojnë 10 Bore tërheqës dhe 10 shpërndarës automatik te kripës, ne bazë te LPP-së nenit 72 kemi kërkuar nga kompania dëshmi për shpërndarësit automatik te kripës dhe bore tërheqësit, brena afatit ligjor kompania nuk ka arritur te ofroj dëshmi për pajisjet e kërkuara. Kompania e ka ofruar një akt noterial sipas procedurës N minutës i cili i vërteton dokumentet qe janë te bashkangjitura ne E-prokurim. Ajo Vërejtja ku shkruhet se Autoriteti Kontraktues do ti verifikoj ne i verifikojmë vetëm dokumentet, verifikimi ne teren bahet ne baze te dokumenteve te kompanisë. Autoriteti Kontraktues vlerëson ne baze te nenit 59 te LPP-së. Sa i përket ne lidhje me librezat dhe Dudat doganor po e përmend Kompaninë "Lika" decidivisht shkruan ne libreze te regjistrimit si shembull ceket Kamion i integruar Bore tërheqësi dhe shpërndarësi i kripës.

Kompania El-Bau SHPK ne DT dhe njoftimin për kontrate tek kapacitetet teknike dhe profesionale është kërkuar qe pajisjet te dëshmohen me libreza te regjistrimit (pajisjet duhet te jen me afat te regjistrimit), Kompania Elbau ne ofertën e tyre ka ofruar një kamion 06-397-Dl pa afat te regjistrimit ato dokumente te cilat kërkohen 3 muaj para si gjykata e te. Ne DT gjithashtu janë kërkuar 10 shpërndarës automatik te kripës ndërsa OE ka ofruar vetëm për 6 Shpërndara automatik te kiper ku i mungojnë 4 nga ta sipas kërkese, Ne bazë te LPP-së neni 109 parg. 1dhe neni 9 i rregullores për paraqitjen për rishqyrtim pran Autoriteti Kontraktues thotë kërkesa për rishqyrtim duhet te jetë e nyejt me ankesën e cila deponohet ne OSHP. Kompania ElBau ne ankesën e drejtuar tek OSHP ne çdo nen ka shtuar pretendimet ankimore ne OSHP, gjithashtu e ka shtuar nenin 64, 108,nenin 4.4 te RrUOPP-së Ne DT edhe njoftimin për kontrate është cekur vëmendje: nëse OE aplikon për te dy pjesët duhet ta ketë stafin dyfishuar, qarkullimin gjithashtu edhe pajisjet, OE i rekomanduar për Lot 2 e ka plotësuar listën për pajisjet për Lot 2 ne baze te LPP-së neni 72 ne i kemi kërkuar një sqarime për cilin lot i ka ofruar pajisjet stafin , OE ne afatin ligjor ka përcaktuar stafi është për Lot 2. Ne DT nuk është ceke ne asnjë pike qe kompania nëse aplikon për te dy loten nëse nuk i ka dokumentet për te dyja ajo eliminohet për te dyja, ne baze te LPP-së lotet janë kontrata, dhe nuk kanëasgjë te përbashkëta.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja profesionale e prokurimit Shqyrtuese znj. Krasniqi deklaroj: Pas shqyrtimit te lendes dhe te gjitha kritereve te parapara ne njoftim për kontrate dhe ne DT dhe te gjitha

dokumentet e dorëzuar nga OE-te gjate hartimit te ekspertizës jam bindur se Autoriteti Kontraktues nuk e ka vlerësuar konform LPP-së dhe RrUOPP-së, AP sepse pa siguruar se OE i rekomanduar për kontrate i plotëson kriteret e para e ka shpërblyer me kontrate. Lidhur me ketë AP kemi 2 ankesa nga Milenium dhe El-Bau te dy ankesat i kam konsideruar si pjesërisht te bazuara. Lidhur me pretendimet e OE ankues se Konsorciumi i OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka plotësuar kriteret e parapara ne njoftim dhe DT qëndron sepse te njëjtat pretendime janë te bazuara sepse siç e kam cekur edhe ne ekspertize OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar për te dy lotet me te njëjtat pajisje, dhe i njëjti nuk i plotëson kriteret për njoftim për kontrate dhe DT. Sepse kriteret ndryshojnë. Autoriteti Kontraktues edhe pse kishte pranuar oferte për te 2 lotët nga OE i rekomanduar për kontrate i bene pyetje OE se për cilin lot keni aplikuar kjo pyetje sugjerohet sugjestive dhe favorizues sepse Autoriteti Kontraktues kishte pranuar oferta nga i njëjti konsorcium për te 2 Lotet, i njëjti kishte ofertuar për 2 lotet dhe sipas njoftimit për kontrate i njëjti është dashtë te eliminohet. E mbështes ne tërësi raportin e dhen ne ekspertize.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së parë ankuese z. Fetoshi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe te aprovohet ankesa jone si e bazuar për 2 Lotët dhe ky Aktivitet i prokurimit te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Pireva deklaroj:Kërkojmë nga Paneli shqyrtues qe te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim dhe te shpallemi si kompania me e përgjegjshme me çmim me te ulet.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Bllaca deklaroj: Kërkojmë qe te refuzohen ankesat e OE-ve ankuese dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Në vazhdim jep konstatimet e tijë lidhur me pretendimet e OE te pare ankues ku sqaron se:
MILENIUM KONSTRUCTION"SH.P.K DHE INTEGRAL SH.P.K. ANKESËN ANKESA NR. NR. 265/19. Lidhur me pretendimin e ankuesit se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, sipas OE ankues. Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se qellim i këtij neni është te sigurojnë mënyrë ma efikase , me transparente dhe më të drejtë te shfrytëzimit te fondeve publike ,duke për caktuare kushtet rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen,te drejtat qe do të respektohen dhe detyrimit qe do te përmbushen, andaj edhe

trajtimi si OE i eliminuar për Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 1 të LPP-së, andaj Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së, sipas OE ankues. Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se qellim i këtij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrë më ekonomike, duke e marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit, andaj trajtimi i OE ankues i eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së, andaj pretendimi i lartcekur është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues" Milenium Konstruction"Sh.p.k dhe Integral Sh.p.k." sh.p.k."Prishtinë, se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE ankues. Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se qëllimi i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe trajtimi si OE i eliminuar, Operatorin ekonomik ankues nuk është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, andaj ky pretendim është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Milenium Konstruction"Sh.p.k dhe Integral Sh.p.k." sh.p.k." Prishtinë, se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit, i cili (pas kërkesës për sqarime) Operatorin Ekonomik ankues e ka trajtuar si OE të eliminuare dhe trajtimi si OE i eliminuare është në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Sepse kriter në njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit (NJ.K. dhe në D.T.) te specifikat teknike janë kërkuar për pjesën-Lot 1 dhjet (10) Borëheqëset (Pollugjet) dhe dhjetë shpërndarit automatik të kripës,gjithashtu edhe për Lot 2 janë kërkuar dhjet (10) Borëheqëset (Pollugjet) dhe dhjet shpërndarësit automatik të kripës.
Kurse OE ankues nuk ka arritur të sjell dëshmi siç janë kërkuar për ta plotësuar këtë kriter, sepse nuk ka ofruar dëshmi se posedon apo ka marr me qira dhjetë(10) shpërndarës të kripës dhe dhjetë (10) Borëheqës (plugjet).

Lidhur me pretendimin e ankuesit se përderisa shkruan në librezë të qarkullimit: Pajisje për pastrim të borës,automatikisht nënkupton se është e kompletuar me pajisje përcjellëse që përfshinë Borëheqësit(plugjet) dhe shpërndarësit automatik të kripës,ndërsa nëse nuk do ishte e kompletuar pajisja do të shkruan Pjesë për pastrimin e borës. Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese

profesionale të prokurimit konstaton se, sa i përket këtij pretendimi sqaroj se (nga 10 Librezat e automjeteve të ofruara) nuk shkruan në të gjitha Librezat Pajisje për pastrimin e Borës, dhe ky pretendim i vet OE ankues bie në kundërshtim me dokumentet e ofruara.

Kërkesa 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 për pjesën I dhe pjesën 2.

Dëshmia 5. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).

Vëmendje: Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Kurse OE nuk ka arritur ti siguroj dëshmi konform NJ.K. dhe në D.T.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se i plotëson kushtet për të dy Lotët dhe është me çmim ma të lirë kurse sa i përket fituesit për Lot 1 dhe Lot 2 nuk ka ndonjë pretendim se nuk i plotëson kushte andaj edhe nuk është analizuar oferta e fituesit për Lotin 1 si dhe oferta e fituesit për Lot 2sepse edhe ashtu nuk ka pasur ndonjë pretendim nga OE ankues përveçse ka pretenduar se oferta e tij i plotëson kriteret për të dy Lotët dhe nuk është respektuar neni 60 i LPP-se. Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar pasi qe ky OE ka ofruar me çmim me te lire por **oferta e këtij OE është e pa përgjegjshme** pasi qe nuk i ka plotësuar kërkesat e vendosura nga AK ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit pasi qe kriter për dhënie ka qene **oferta e përgjegjshme** me çmim me te lire pra Autoriteti Kontraktues e ka respektuar nenin 60 te LPP-së.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet e tij lidhur me pretendimet e OE ankues: "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë, ANKESA nr.Nr.277/19.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë, që pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, sipas OE ankues, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, qëllimi i këtij neni është te sigurojnë mënyre ma efikase,me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimit qe do te përmbushen, andaj edhe trajtimi si OE i eliminuar Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 1 të LPP-së, andaj ky pretendim është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimin e OE ankues'' EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë, qe pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së,sipas OE ankues, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, qellim i këtij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrë me ekonomike,duke e marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit,andaj trajtimi i OE. ankues të eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së. Andaj konstatohet ky pretendim është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë, që pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuare nenin 7 të LPP-së,sipas OE ankues, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, qellim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe trajtimi si OE i eliminuar, Operatorin ekonomik ankues nuk është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së . Andaj konstatohet se ky pretendim është i pa bazuar .

Lidhur me perëndimin e OE ankues"EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë, që pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së,sipas OE ankues, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit i cili OE-ne ankues e ka trajtuar si OE të pa përgjegjshëm - pra te eliminuardhe trajtimi si OE te pa përgjegjshëm - pra tei eliminuar për Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 59të LPP-së .

Sa i përket pretendimit te OE ankues, lidhur me shkeljen e paragrafin 2 dhe 4 të këtij neni, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, i njëjti pretendim nuk qëndron sepse autoriteti kontraktues nuk ka pasur diçka të paqartë rreth regjistrimit të automjetit sepse te njëjtat gjinden në Librezën e Automjetit dhe ka qen e çart për AK-në Automjeti është pa regjistrim kurse në NJ.K. dhe në D.T. ka qen kriter që automjetet duhet të jenë të regjistruara,ketë e pranon edhe vet OE ankues me rastin e përpilimit të kësaj ankese.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se mos regjistrimi i Automjetit hyjnë ne devijime te vogla dhe nuk është rrethanë relevante, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, çdo kriter është relevant dhe i obligueshëm për ofertuesit dhe Autoritetin Kontraktues. Ky pretendim ndërlidhet me nenin 39 të RRUOP-it ku ekskluzivisht nuk e sqaron për

regjistrimin e automjetit por e njëjta hyn te specifikat teknike në aneksin 1 te D.T. andaj mos përmbushja e Specifikave teknike edhe në RRUOP, te sqarimet parashihet të refuzohet tenderi .

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë,që pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së,sipas OE ankues, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar pasi qe ky OE ka ofruar me çmim me te lire por **oferta e këtij OE është e pa përgjegjshme** pasi qe nuk i ka plotësuar kërkesat e vendosura nga AK ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit pasi qe kriter për dhënie ka qene **oferta e përgjegjshme** me çmim me te lire, pra Autoriteti Kontraktues e ka respektuar nenin 60 te LPP-së. qëllimi i këtij neni është të respektohen kriteret për dhënien e kontratës dhe kriter për dhënien e kontratës ka qenë :Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE ankues i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. nuk qëndron dhe është i pa bazuar, ndërsa Lidhur me pretendimin e OE ankues"EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë, që pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka respektuar nenin 64 të LPP-së, sipas OE ankues Lidhur me pretendimin se kërkesa –kriteri që ishte që Regjistrimi i mjeteve nuk është kategori që aplikohet në bazë te LPP-së dhe pretendimi se ky kriter është i pa bazuar në ligj, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, në ketë fazë nuk mund të kontestohen kriteret siç është paraparë kriteri për Regjistrimin e automjeteve dhe është nënë kompetencat e AK-së të caktojë kriteret e në raste kur OE-te nuk pajtohen me kriteret e përcaktuar janë afatet për sqarime kur OE mund të kërkon ti ndryshojnë apo ti heqin ato kritere e assesi në këtë fazë. Andaj konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues"EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. Prishtinë që pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 69 të LPP-së, sipas OE ankues.

Paneli shqyrtues konformekspertit shqyrtues profesional konstaton se përmes këtij neni AK-së mund të kërkoj disa sqarime nga OE. te siguroj dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale te kërkuara me DT. Dhe NJ.K. Aftësia teknike dhe profesionale e Ofertuesve andaj lidhur me pretendimin se nuk është zbatuar par 4.5 i këtij neni që nënkupton raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve dhe pretendimi i OE ankues se të njëjtat i posedon dhe padrejtësisht është eliminuar nga gara sipas OE ankues, Paneli shqyrtues konform sqarimeve të Ekspertes shqyrtuese profesionale të prokurimit konstaton se, pretendimi i OE ankues nuk qëndron sepse OE ankues nuk i posedon mjetet siç janë kërkuar me NJ. K. dhe D.T.(siç është sqaruar në përgjigjeje nr.5)

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EL-BAU"sh.p.k.& CONEX GROUP" sh.p.k. "Prishtinë,që pretendon se Ministria e Infrastrukturës nuk ka respektuar nenin 72 të LPP-së,sipas OE ankues Paneli shqyrtues konform ekspertes shqyrtuese profesionale konstaton se Ekspertja sqaron se në bazë të këtij neni mund të kërkohen sqarime ,Shih nenin 72 te LPP-së *Dokumentacioni dhe informacioni shtesë:*

1.Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3.Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Andaj ky pretendim është i përsëritur dhe i njëjti është sqaruar në Përgjigjeje nr.5

Paneli shqyrtues sqaron se Operatoret ankues pretendimet e tyre ne kërkesat për rishqyrtim i kane patur vetëm lidhur me eliminimin e tyre dhe jo edhe për operatoret ekonomik te rekomanduar për kontrate andaj Lidhur me pretendimin e OE ankues, qe kane te bëjnë me OE-te e rekomanduar për kontrate, paneli shqyrtues sqaron se këto pretendime nuk ka qenë pretendime ankimor tek kërkesa për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.

Paneli shqyrtues me rastin e marrjes së këtij vendimi, është bazuar në pretendimet ankimore të parashtruara tek kërkesa për rishqyrtim dhe tek ankesa e dorëzuar në OSHP, sepse në nenin 9.2 tek Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, shkruan decidivisht se pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato te paraqitura në Autoritetin Kontraktues, ndërsa çdo pretendim tjetër që është ngritur në seancë dëgjimore dhe që nuk ka kaluar nëpër filtrat e rishqyrtimit tek autoriteti kontraktues nuk është marr parasysh dhe nuk është i përfshirë në këtë vendim .

Paneli shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh që nuk ka qenë kërkesë decidive e AK-së që operatorët ekonomik qe ofertat e tyre i dorëzojnë për dy Lotët, nëse nuk i plotësojnë kërkesat e AK-se për te dy Lotët do te eliminohen, vjen në përfundim se sikur AK do ta kishte eliminuar ndonjë OE atëherë do te kishte vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 3 të LPP-së, duke eliminuar ndonjë OE për kërkesa që nuk

janë parashikuar në dosje të tenderit, kurse paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së shkruan *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Autoriteti Kontraktues ne këtë rast te gjithë OE i ka trajtuar ne mënyrë te barabarte konform nenit 7 te LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se te gjithë Operatoret Ekonomik te cilët kane plane te ofertojnë ne një aktivitet te prokurimit duhet qe ti përgatisin ofertat e tyre me kohe konform kërkesave te vendosura nga Autoriteti Kontraktues ne njoftimin për kontrate dhe dosjet e tenderit, periudha prej publikimit te njoftimit për kontrate e deri ne dorëzim te ofertës se tyre, ju shërben atyre për këtë çështje, Rrjedhimisht Operatoret Ankues kane dështuar te ofrojnë fakte dhe prova pranë Autoritetit kontraktues me kohe kur i kane dorëzuar ofertat e tyre, gjithashtu e kane patur mundësinë e dyte kur AK gjate fazës se vlerësimit ka kërkuar prej tyre konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se, ta ofrojnë dokumentacionin qe ti plotësojnë te gjitha kërkesat e AK-se te publikuara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit, prape këta dy OE ankues kane dështuar.

Paneli shqyrtues sqaron se Afatet kohore janë te përcaktuara me LPP dhe legjislacionin dytësor dhe ato afate duhet te respektohen nga te gjitha palët ne procedurë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për Lotët –Pjesët qe ankuesit kane parashtruar ankese është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, e ne këtë rast AK-MI ka vepruar konform këtij neni.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, e ne këtë rast AK-MI ka vepruar konform këtij neni.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –"Ministria e Infrastrukturës"

1x1 OE-"Millenium Konstruction shpk & Integral sh.p.k"

1x1 OE-"El Bau shpk& Conex Group"shpk

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.